



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

Nr. 879/prot.
2

Tiranë, më 22.02.2024

NJOFTIM PUBLIK

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR KOMPENSIMIN FINANCIAR
TË PRONARËVE, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA
NDËRTIMET INFORMALE, SIPAS VKM NR. 36, DATË 24.01.2024**

Në zbatim të VKM Nr.383, datë 19.05.2010 “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”, i ndryshuar, Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) njofton:

- Fillimin e procesit të pranimit të kërkesave për kompensimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet informale, gjeneralitetet dhe të dhënat e të cilëve janë sipas **VKM Nr. 36 datë 24.01.2024**.
- Procesi i pranimit të kërkesave të subjekteve përfituesve do të fillojë **në datën 27.02.2024** dhe nuk do të jetë i kushtëzuar dhe i kufizuar në kohë.
- ATP fton të gjithë subjektet e interesuara, që në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, Nr. 158 Prot., datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 01.01.2020”, të aplikojnë online në portalin e-albania “Aplikim për kompensim në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale”.
- Subjekti aplikues (subjekti përfitues/trashëgimtari ligjor/përfaqësuesi me prokurë), në momentin e aplikimit online, duhet të ngarkojë dhe më ps të dërgojë nëpërmjet shërbimit postar në adresën rruga “Muhamet Gjollësja”, Nr. 54, Tiranë, dokumentacionin si më poshtë (origjinal/të njësuar me origjinalin):
 1. Kërkesën për kompensimin e pronës, sipas formatit tip, që i vihet në dispozicion nga ATP;
 2. Dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil;

3. Prokurën e posaçme, të nënshkruar nga të gjithë subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre. (Në rastet kur nuk është e mundur të dorëzohet prokura e posaçme, secili bashkëpronar apo një pjesë e tyre, paraqesin kërkesë individuale apo të përbashkët, për pjesën takuese në pronën që kompensohet. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjese të tyre, për çdo kërkesë të kryer, paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 000 (dymijë) lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme);
4. Vërtetimin original të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare (IBAN), ku do të transferohet vlera financiare e përfituar;
5. Fotokopjen e dokumentit të identifikimit;
6. Mandat pagesën, që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit në vlerën 2 000 (dymijë) lekë.

Subjektet përfituese, kërkesa e të cilëve nuk është pranuar për mungesë dokumentacioni gjatë procedurave të mëparshme, kanë të drejtë të riaplikojnë. Këto subjekte nuk paguajnë tarifë shërbimi, nëse provojnë pagimin e saj gjatë aplikimit të mëparshëm.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Geraldo DURDAJ

